

PETICION



Kërkojmë respektim të të drejtave të riprodhimit!

Kërkojmë respektim të të drejtës themelore të çdo njeriu, lirshëm dhe në mënyrë të pavarur të vendosë se a do të ketë fëmijë, sa dhe kur do të ketë fëmijë!

Vendimet e riprodhimit duhet të jenë të lira nga çdo lloj diskriminimi apo detyrimi!

■ Çdo ditë ballafaqohemi me promovimin agresiv të vlerave të vjetra patriarkale dhe rolet stereotipe të grave dhe burrave. Agresioni i medimeve shkon drej kufizimit të lirisë individuale, dhënien me forcë të identiteteve, prioriteteve dhe stileve të jetës. Në emër të traditës dhe konservatizmit promovohen ide të cilat i rrezikojnë përfitimet e arritura të zhvillimit shoqëror dhe social.

■ Të drejtat e riprodhimit nuk janë dhe nuk duhet të konsiderohen si “autokraci e grave”. Riprodhimi është çështja politike më e ndjeshme e cila për shekuj me rradhë është mjet manipulimi dhe keqpërdorimi. Kjo çështje shumë gjatë ka shërbyer për krijim dhe riprodhim të sistemit i cili i zhvlerëson dhe kufizon potencialet individuale të ndryshme të grave.

■ Shoqëria e përgjegjshme duhet të promovojë dhe të formulojë politika të cilat do të sigurojnë kushte dhe përkujdesje për barazi sociale, kulturore dhe ekonomike për të gjithë!

■ Shoqëria duhet të sigurojë gjithashtu edhe kushte në të cilat gruaja do të ketë të drejtë ta planifikojë shtatzaninë e vet, kurse nëpërmjet kësaj edhe pjesën tjetër të jetës personale.

PRANDAJ U BËJMË THIRRJE:

KUVENDIT POPULLOR (DHE KOMISIONEVE KOMPETENETE):

- ▶ Të jenë kundër sjelljes së ligjeve që janë në kundërshtim me Kushtetutën si akti juridik më i lartë;
- ▶ Të ndalohet miratimi i zgjidhjeve ligjore diskriminuese të cilat nuk janë në pajtim me konventat ndërkombëtare të ratifikuara;
- ▶ Të ndër marrë rol aktiv në promovimin e të drejtave të riprodhimit dhe të drejtës të gëzimit të njëjtë padiskriminim dhe detyrim.

QEVERISË:

- ▶ T'i rishqyrtojë politikat për rritjen e natalitetit dhe instrumentave për realizimin e tyre;
- ▶ T'i lëshojë programet për promovim të mëmësisë profesionale dhe praktikës së shfrytëzimit joracional të mjeteve të buxhetit për fushata moralizuese me përmbajtje fetare;
- ▶ T'i promovojë të drejtat seksuale dhe riprodktive dhe mekanizmat për mbrojtjen e tyre, në vend të ideologjisë të konservatizmit dhe demokristianizmit;
- ▶ Të zhvillojë politika dhe programe efektive për lehtësimin e qasjes të grave në tregun e punës, përparimin dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre në marrëdhëniet e punës, infrastrukturën sociale dhe mbështetjen për harmonizim të jetës profesionale me jetën familjare.

MINISTRIVE KOMPETENTE:

- ▶ Të jenë transparente dhe të formulojnë qëndrim të qartë për çështje të cilat i prekin të drejtat e riprodhimit;
- ▶ T'i planifikojnë dhe t'i argumentojnë politikat në bazë të analizave shkencore të qëndrueshme dhe t'i parashikojnë pasojat e mundshme negative të zbatimit të tyre, kurse në konsultim me opinionin ekspert;
- ▶ Të sigurojnë qasje në mjetet për kontracëpsion, mundësi për ndalim të shtatëzanisë së paplanifikuar apo të padëshirueshme dhe intervenim mjekësor të sigurt në institucione të akredituara.

KËSHILLIT TË RADIFUZIONIT:

- ▶ Të kujdeset për zbatim përkatës të standardeve të programeve tek radiodifuzerët, në përputhshmëri me mandatin e tij si organ rregullator i pavarur me kompetenca publike;
- ▶ Të ndër marrë masa për sanksionim të mosrespektimit të parimit të barazisë së lirive dhe të drejtave, pavarësisht nga gjinia, raca, prejardhja nacionale, etnike dhe sociale.